

LIGJ

Nr. 8989, date 23.1.2003

PER ADERIMIN E REPUBLIKES SE SHQIPERISE NE "KONVENTEN
NDERKOMBETARE PER MATJEN E TONAZIDT TE ANIJEVE", 1969

Ne mbeshtetje te neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 te Kushtetutes, me propozimin e Keshillit te Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqiperise aderon ne "Konventen nderkombetare per matjen e tonazhit te anijeve", 1969.

Neni 2

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3680, date 10.2.2003 te Presidentit te Republikes se Shqiperise, Alfred Moisiu.

KONVENTA
NDERKOMBETARE PER MATJEN E TONAZHIT TE ANIJEVE, 1969

Qeverite Kontraktuese:

Duke deshiruar qe te krijojne parime dhe rregulla uniforme ne lidhje me percaktimin e tonazhit te anijeve te perfshira ne udhetime nderkombetare;

Duke konsideruar se ky perfitim mund te arrihet me mire nga perfundimi i nje Konvente,

bien dakord si vijon:

Neni 1

Detyrime te pergjithshme sipas Konventes

Qeverite kontraktuese do te perpiqen per te bere efektive parashikimet e Konventes aktuale dhe anekseve bashkelidhur, te cilat perbejne nje pjese integrale te Konventes aktuale. cdo refetim ne Konventen aktuale perben ne te njejten kohe nje referim tek anekset.

Neni 2 Percaktimet

Per qellimet e kesaj Konvente, pervecse kur eshte parashikuar shprehimisht ndryshe:

1. "Rregulla" nenkupton rregullat e bashkelidhura Konventes aktuale.
2. "Administrata" nenkupton Qeverine e shtetit, flamurin e te ciles mban anija.
3. "Udhetim nderkombetar" nenkupton nje udhetim detar, nga nje shtet ne te cilin zbatohet Konventa aktuale ne nje port jashte nje shteti te tille ose e kunderta. Per kete qellim, cdo territor per lidhje nderkombetare, nga te cilat nje Qeveri kontraktuese eshte pergjegjese ose per te cilin Kombet e Bashkuara jane autoriteti administrues, konsiderohet nje shtet i vecante.
4. "Tonazhi Bruto" nenkupton matjen e madhesis se pergjithshme te nje anijeje te percaktuar ne perputhje me parashikimet e Konventes aktuale.
5. "Tonazhi neto" nenkupton matjen e madhesis se kapacitetit te perdorshem te nje anijeje te percaktuar ne perputhje me parashikimet e Konventes aktuale.
6. "Anije ere" nenkupton nje anije e cila eshte shtrire ose e cila eshte ne gjendje te ngjashme te ndertimit, ne ose pas dates se ardhjes ne fuqi te Konventes aktuale.
7. "Anije ekzistuese" nenkupton nje anije e cila nuk eshte nje anije e re.
8. "Gjatesi" nenkupton 96 per qind te gjatesise totale ne vijen e ujit ne 85 per qind te se paku pershkrimtit te matur ne fund te kilit ose gjatesise se vijes se ujit nga pjesa maksimale e bashit deri tek kici ne aksin e timonit, nese kjo eshte me e madhja. Ne projektet e anijeve me fund te sheshte vija e ujit ne te cilen matet kjo gjatesi do te jete paraleli me vijen e ujit te projektuar.
9. "Organizate" nenkupton Organizaten Konsultative Nderqeveritare Detare.

Neni 3 Zbatimi

1. Konventa aktuale do te zbatohet ne anijet qe kryejne udhetime nderkombetare si vijon:

- a) anijet e regjistruara ne vendet e qeverive te cilat jane Qeveri Kontraktuese;
- b) anijet e regjistruara ne territoret ne te cilet Konventa aktuale eshte shtrire sipas nenit 20; dhe
- c) anijet e paregjistruara qe mbajne flamurin e shteteve, qeverite e te cileve jane Qeveri Kontraktuese.

2. Konventa aktuale do te zbatohet per:

- a) anijet e reja;
 - b) anijet ekzistuese, te cilat pesojne ndryshime ose modifikime, te cilat Administrata i konsideron si nje ndryshim thelbesor ne tonazhin e tyre ekzistues bruto;
 - c) anijet ekzistuese nese e kerkon ate pronari; dhe
 - d) te gjitha anijet ekzistuese, dymbedhete vjet pas dates ne te cilen Konventa hyn ne fuqi, me perjashtim te anijeve te tilla, pervec atyre te permendura ne (b) dhe (c) te ketij paragrafi, do te mbajne tonazhet e tyre ekzistuese per qellimet e zbatimit ne to, te kerkesave perkatese sipas konventave te tjera ekzistuese nderkombetare.
3. Anijet ekzistuese mbi te cilat Konventa aktuale eshte zbatuar ne perputhje me nenparagrafin (2) (c) te ketij neni, si rrjedhim nuk do te kene te percaktuar tonazhet e tyre ne perputhje me kerkesat qe Administrata zbaton mbi anijet e udhetimeve nderkombetare perpara hyrjes ne fuqi te Konventes aktuale.

Neni 4 Perjashtimet

1. Konventa aktuale nuk do te zbatohet per:

a) anijet e luftes;

b) anijet me te vogla se 24 metra (79 kembe) ne gjatesi.

2. Asgje nga kjo Konvente nuk do te zbatohet per anijet qe lundrojne vetem ne zonat qe vijojne:

a) liqenet e medhenj te Amerikes se Veriut dhe lumi St. Lawrence aq larg ne lindje te vijes se rombit te hequr nga Cap Des Rosiers deri ne West Point, ishullin Anticosti dhe ne pjesen e veriut te ishullit Anticosti, meridianit me gjatesi 63° W;

b) detin Kaspik;

c) ne Plote, Parana dhe lumin Uruguaj aq larg ne lindje te vijes se rombit te 'hequr ndermjet Punta Rasa (Cabo San Antonio), Argjentina dhe Punta del Este, Uruguai.

Neni 5 Force majeure

1. Nje anije qe nuk eshte subjekt i parashikimeve te kesaj Konvente, ne kohen e nisjes se saj ne cdo lundrim nuk do te behet subjekt i parashikimeve te tilla, per sa i perket cdo devijimi nga udhetime i menduar i saj si rezultat i kushteve te kohes ose cdo shkaku tjetër te force majeure.

2. Ne zbatimin e parashikimeve te Konventes aktuale, qeverite Kontraktuese do t'i japin rendesine e duhur cdo devijimi ose vonese te shkaktuar kundrejt cdo anijeje, per arsye te ndikimit te kohes ose cdo shkaku tjetër te force majeure.

Neni 6 Percaktimi i tonazheve

Percaktimi i tonazheve bruto dhe neto do te kryhet nga. administrata, e cila megjithate mundet t'ia besojë nje percaktim te tille personave ose organizatave te njohura nga ajo. Ne cdo fast, administrata e interesuar do te pranojë pergjegjesine e plate per percaktimin e tonazheve bruto dhe neto.

Neni 7 Leshimi i Certifikatave

1. Cdo anijeje duhet t'i leshohet nje Certificate Nderkombetare Tonazhi (1969), tonazhet bruto dhe neto te se ciles jane percaktuar ne perputhje me Konventen aktuale.

2. Certifikata te tilla do te leshohen nga administrata, nga persona ose organizata te autorizuara nga ajo. Ne cdo rast, administrata do te mane pergjegjesine e plate per Certifikaten.

Neni 8

Leshimi i Certifikates nga nje qeveri tjetër

1. Nje Qeveri Kontraktuese, me kerkesen e nje Qeverie tjetër Kontraktuese, mundet te percaktojë tonazhet bruto dhe neto te nje anije dhe te leshojë ose autorizojë leshimin e nje Certificate Nderkombetare Tonazhi, (1969) nje anijeje, ne perputhje me Konventen aktuale.

2. Nje kopje e Certifikates dhe nje kopje e llogaritjeve te tonazheve do t'i

transmetohet sa me shpejt te jete e mundur Qeverise Kontraktuese.

3. Nje Certifikate e leshuar ne kete menyre do te permbaje nje deklarate me qellimin e shpjegimit qe ajo eshte leshuar me kerkesen e qeverise se shtetit, flamurin e te cilit mban ose do te mbaje anija dhe ajo do te kete te njejtin vlefshmeri, dhe do te marre te njejten njohje si nje Certifikate e leshuar sipas nenit 7.

4. Asnje Certifikate Nderkombetare Tonazhi, (1969) nuk do t'i leshohet nje anijeje e cila mban flamurin e shtetit, qeveria e te cilit nuk eshte Qeveri Kontraktuese.

Neni 9 Forma e Certifikates

1. Certifikata do te pergatitet ne gjuhete zyrtare ose gjuhete zyrtare te shtetit leshues. Nese gjuha e perdorur nuk eshte as anglisht dhe as frengjisht, teksti duhet te perfshije nje perkthim ne njeren nga keto gjuhe.

2. Forma e Certifikates duhet t'i korrespondoje modelit te dhene ne aneksin II.

Neni 10 Anulimi i Certifikates

1. Mbi bazen e cdo perjashtimi te parashikuar ne rregullat, nje Certifikate Nderkombetare Tonazhi, (1969) do te pushoje te jete e vlefshme dhe do te anulohet nga administrata, nese ndryshimet kane ndodhur ne pajisjet, konstruksionin, kapacitetin, perdorimin e hapësirave, numrin total te udhetareve qe anijes i lejohet te transportoje, sic tregohet ne certifikaten e anijes per udhëtdret, ne vijen e ngarkeses se caktuar ose peshkimin e lejuar te anijes, qe mund te bejne te nevojshme nje rritje te tonazheve bruto dhe neto.

2. Nje Certifikate e leshuar nje anijeje nga administrata do te pushoje te jete e vlefshme menjehere pas transferimit te nje anijeje te tille ne flamurin e nje shteti, tjeter me perjashtim, sic parashikohet ne paragrafin 3 te ketij neni.

3. Me transferimin e nje anije ne flamurin e nje shteti tjeter, qeveria e te cilit eshte Qeveri Kontraktuese, Certifikata Nderkombetare e Tonazhit, (1969) do te mbetet ne fuqi per nje periudhe qe nuk i kalon tre muaj ose derisa Administrata leshon nje Certifikate Nderkombetare te Tonazhit, (1969) per ta zevendesuar ate ciladoqofte me perpara Qeveria Kontraktuese e Shtetit, flamurin e te cilit mbante anija, do t'i transmetoje administrates sa me shpejt te jete e mundur, pasi transferimi te kete ndodhur, nje kopje te Certifikates qe mban anija ne kohen e transferimit dhe nje kopje te llogaritjeve perkatese te tonazheve.

Neni 11 Pranimi i Certifikates

Certifikata e leshuar nen autoritetin e Qeverise Kontraktuese ne perputhje me Konventen aktuale do te pranohet nga nje Qeveri tjeter Kontraktuese dhe persa i perket te gjithë qellimeve te mbuluara nga Konventa aktuale, sikur te kishte te njejten vlefshmeri si Certifikatat e leshuara nga ato.

Neni 12 Inspektimi

1. Nje anije qe mban flamurin e nje shteti, qeveria e te cilit eshte Qeveri Kontraktuese, kur eshte ne portet e Qeverise tjeter Kontraktuese, do te jete subjekt i inspektimeve nga

nepunesit e autorizur nga qeveri te tilla. Inspektime te tilla do te kufizohen ne qellimin e verifikimit:

- a) se anija eshte e pajisur me nje Certificate Nderkombetare Tonazhi (1969);
 - b) se karakteristikat kryesore te anijes korrespondojne me te dhenat ne Certificate.
2. Ne asnje rast ushtrimi i inspektimeve te tilla nuk do te shkaktoje ndonje vonese te pamjes.
3. Nese inspektimi zbulon se karakteristikat kryesore te anijes ndryshojne nga ate te shenuara ne Certificate Nderkombetare te Tonazhit (1969), qe sjellin nje rritje ne tonazhin brute dhe neto, Qeveria e shtetit, flamurin e te cilit mban anija, do te njoftohet pa asnje vonese.

Neni 13 Privilegjet

Privilegjet e Konventes aktuale mund te mos reklamohen ne favor te do anijeje, perderisa ajo te mbaje nje Certificate te vlefshme sipas kesaj Konvente.

Neni 14

Traktatet, konventat dhe marreveshjet e meparshme

1. Te gjitha traktatet, konventat dhe marreveshjet e tjera ne lidhje me eshtjet e tonazhit aktualisht ne fuqi nga Qeverite Pale te Konventes aktuale, do te vazhdojne qe te jene fuqi te plote gjate konditave versa i perket:

- a) anijeve te cilave nuk zbatohet Konventa aktuale;
- b) anijeve te cilave Konventa aktuale zbatohet, ne lidhje me ceshtjet per te cilat ajo nuk ka parashikuar te shprehet.

2. Ne vazhdim, nese Konventa, traktate dhe marreveshje te tilla bien ne kundersizim me parashikimet e Konventes aktuale, parashikimet e Konventes aktuale do te mbizoterojne.

Neni 15 Komunikimi i informacionit

Qeverite Kontraktuese zotohen te komunikojne dhe depozitojne tek Organizata:

- a) nje numer te mjaftueshem specimenesh te certifikatave te tyre te leshuara sipas parashikimeve te Konventes aktuale per qarkullim te gjitha Qeverive Kontraktuese;
- b) tekstin e ligjeve, urdhrave, dekreteve, rregulloreve dhe instrumenteve te tjera te cilat jane publikuar mbi eshtje te ndryshme brenda qelimit te Konventes aktuale.
- c) nje liste te agjencive jo qeveritare, te cilat jane autorizuar te veprojne ne emer

te

tyre ne lidhje me tonazhet per t'ia qarkulluar Qeverive Kontraktuese.

Neni 16

Firmosja, pranimi dhe bashkimi

1. Konventa aktuale do te mbetet e hapur per firmosje per 6 muaj nga 23 qershori 1969 dhe me pastaj do te mbese e hapur per bashkim. Qeverite e shteteve anetare te Kombeve te Bashkuara ose te agjencive te specializuara, ose te Agjencise Nderkombetare te

Energjise Atomike, ose Paleve ne Statutin e Gjykatën Nderkombetare te Drejtesise mund te behen Pale ne Konvente me:

- a) firmosjen pa asnje rezerve per pranim;
- b) firmosjen mbi bazen e pranimet te ndjekur nga pranimi;
- c) bashkim.

2. Pranimi ose bashkimi do te realizohen me depozitim e nje instrumenti pranimi ose bashkimi per Organizaten. Organizata do te informoje te gjitha qeverite te cilat kane firmosur Konventen aktuale ose jane bashkuar me te per cdo pranim, ose bashkim te ri dhe daten e depozitimit te tij. Organizata do te informoje gjithashtu te gjitha qeverite te cilat kane firmosur tashme Konvetnen, per cdo firmosje te kryer gjashte muajve nga 23 qershori 1969.

Neni 17 Ardhja ne fuqi

1. Konventa aktuale do te hyje ne fuqi 24 muaj pas dates ne te cilen jo me pak se njezet e pese qeveri te shteteve, flotar e kombinuara tregtare te te cileve perbejne jo me pak se gjashtedhete e pese perqind te tonazhit brute, te transportit tregtar boteror, kane firmosur pa rezerva per pranimin ose kane depozituar instrumentet e pranimet ose bashkimit ne perputhje me nenin 16. Organizata do te informoje te gjitha qeverite te cilat kane firmosur ose kane hyre ne Konventen aktuale per daten ne te cilen ajo hyn ne fuqi.

2. Per qeverite te cilat kane depozituar nje instrument pranimi ose bashkimi per Konventen aktuale gjate njezet e kater muajve te permendura ne paragrafin 1 te ketij neni, pranimi ose bashkimi do te hyje ne veprim me hyrjen ne fuqi te Konventes aktuale tre muaj pas dates se depozitimit te instrumentit te pranimet ose bashkimit, ciladoqofte data e mevoneshme.

3. Per qeverite te cilat kane depozituar nje instrument pranimi ose bashkimi per Konventen aktuale, pas dates ne te cilen ajo hyn ne fuqi, Konventa do te hyje ne fuqi tre muaj pas dates sedepozitimit te nje instrumenti te tille.

4. Pas dates ne te cilen te gjitha mat jet e kerkuara per te nxjerre nje amendament per Konventen aktuale ne fuqi jane pefunduar, ose te gjitha pranimet e nevojshme duket se jane dhene sipas nenparagrafit b, te paragrafit 2 te nenit 18 ne rastet e amendamenteve me pranim unanim, cdo instrument pranimi ose bashkimi i depozituar do te konsiderohet si kerkese ndaj Konventes sic amendohet.

Neni 18 Amendamentet

1. Konventa aktuale mund te amendohet me propozimin e nje Qeverie Kontraktuese

me anen e njerës nga procedurat te specifikuara ne kete nen.

2. Amendament me pranim unanim:

a) Me kerkesen e nje Qeverie Kontraktuese, cdo amendament i propozuar nga ajo per Konventen aktuale, do t'i komunikohet nga Organizata te gjithë Qeverive Kontraktuese per ta marre ne konsiderate me qellimin e pranimet unanim.

b) cdo amendament i tille do te hyje ne fuqi dymbedhete muaj pas dates se pranimet te tij nga te gjithë Qeverite Kontraktuese, pervecse kur eshte rene dakord per nje date me perpara. Nje Qeveri Kontraktuese, e cila nuk komunikon pranimin e saj ose mospranimin

e amendamentit kundrejt Organizates brenda njezet e kater muajve nga komunikimi i saj i pare, me vone do te konsiderohet sikur e ka pranuar amendamentin.

3. Amendamenti pas marrjes ne konsiderate nga Organizata: a) Me kerkesen e nje Qeverie Kontraktuese, cdo amendament i propozuar nga ajo per Konventen aktuale do te merret ne konsiderate nga Organizata. Nese adaptohet nga nje mazhorance prej dy te tretave te atyre prezent dhe qe votojne ne Komitetin e Sigurise Detare te Organizates, nje amendament i tille do t'i komunikohet te gjitha anetareve te Organizates dhe te gjitha Qeverive Kontraktuese, se paku gjashte muaj perpara marrjes se saj ne konsiderate nga Asambleja e Organizates.

b) Nese adaptohet nga nje mazhorance prej dy te tretave te atyre qe jane prezent dhe votojne ne Asamble, amendamenti do t'i komunikohet nga Organizata te gjitha Qeverive Kontraktuese per pranimin nga ana e tyre.

c) Amendamente te tilla do te hyjne ne fuqi dymbedhjete muaj pas dates ne te cilen ato jane pranuar nga dy te tretat e Qeverive Kontraktuese. Amendamenti do te hyje ne fuqi ne lidhje me te gjitha qeverite kontraktuese me perjashtim te atyre, te cilat perpara hyrjes ne fuqi te tij, bejne nje deklarate qe ato nuk e pranojne amendamentin.

d) Asambleja, me dy te tretat e mazhorances se atyre qe jane prezent dhe votojne, duke perfshire dy te tretat e Qeverive te perfaqesuar ne Komitetin e Sigurise Detare, qe jane prezent dhe votojne ne Asamble, mund te propozojne nje percaktim ne kohen e adaptimit te tij qe nje amendament eshte i nje natyre te rendesise se tille qe cdo Qeveri Kontraktuese, e cila ben nje deklarim sipas nenparagrafit (c) te ketij paragrafi dhe qe nuk e pranon nje amendament brenda nje periudhe prej dymbedhjete muajsh pas hyrjes se tij ne fuqi, do te pushoje te jete nje Pale ne Konventen aktuale me tejkalimin e kesaj periudhe. Ky percaktim do te jete subjekt i pranimin perpara dy te tretave te Qeverive Kontraktuese.

e) Asgje ne kete paragraf nuk do t'i ndaloje Qeverite Kontraktuese te 'cilat propozojne, te parat veprime sipas ketij paragrafi mbi nje amendament per Konventen aktuale, nga marrja' ne cdo kohe te cfaredo veprimi alternativ te tille sic mund t'u duket atyre, te deshirueshme ne perputhje me paragrafet (2) ose (4) te ketij neni.

4. Amendamentet nga nje Konference:

a) Me kerkesen e nje Qeverie Kontraktuese, te harmonizuar nga se paku nje e treta e Qeverive Kontraktuese, do te mbledhet nje Konference e Qeverive nga Organizata, per te marre ne konsiderate amendamentet per Konventen aktuale.

b) Cdo amendament i adaptuar nga nje Konference e tille, me mezhorance prej dy te tretat te Qeverive Kontraktuese qe marrin pjese dhe votojne per pranimin e tyre.

c) Amendamente te tilla do te hyjne ne fuqi dymbedhjete muaj pas dates ne te cilen ato pranohen nga dy te tretave e Qeverive Kontraktuese. Amendamenti do te hyje ne fuqi ne lidhje me te gjitha qeverite kontraktuese, duke perjashtuar ato, te cilat, perpara hyrjes ne fuqi, kane here nje deklarate qe nuk e pranojne amendamentin.

4) Nga nje mazhorance prej dy te tretave te atyre qe marrin pjese dhe votojne, nje - Konference e mbledhur sipas nenparagrafit (a) te ketij paragrafi mund te vendose ne kohen e adaptimit te tij, qe nje amendament eshte i nje rendesie te tille qe cdo Qeveri Kontraktuese, e

cila ben nje deklarate sipas nenparagrafit (a) te ketij paragrafi, dhe e cila nuk pranon amendamentin brenda nje periudhe prej dymbedhjete muajsh pas hyrjes se saj ne fuqi, do te pushoje te jete Pale ne Konventen aktuale me tejkalimin e periudhes.

5. Organizata do te informoje te gjitha Qeverite Kontraktuese per cdo amendament i cili mund te hyje ne fuqi sipas ketij neni, se bashku me daten ne te cilen secili amendament i tille do te hyje ne fuqi.

6. Cdo pranim ose deklarate sipas ketij neni do te kryhet me anen e depozitimit te nje instrumenti tek Organizata, e cila do te njoftoje te gjitha Qeverite Kontraktuese per marrjen e pranimet ose deklarimit.

Neni 19 Denoncimi

1. Konventa aktuale mund te denoncohet nga nje Qeveri Kontraktuese ne cdo kohe

pas skadimit te pese vjeteve nga data ne te cilen Konventa hyri ne fuqi per qeverine.

2. Denoncimi do te kryhet me depozitimin e nje instrumenti tek Organizata, e cila do te informoje te gjitha Qeverite e tjera Kontraktuese per nje denoncim te tille te marre dhe daten e marrjes se tij.

3. Nje denoncim do te hyje ne fuqi nje vit ose per nje periudhe aq te gjate sic mund

te specifikohet ne instrumentin e denoncimit, pas marrjes se tij nga Organizata.

Neni 20 Territoret

1. a) Kombet e Bashkuara, ne rastet kur ato Jane autoritete administruese per nje territor ose cdo Qeveri Kontraktuese pergjegjese per marredheniet nderkombetare te nje territori, sa me shpejt te jete e mundur, do te konsultohen me keto territore ose do te marrin masa te tilla qe mund te jene te pershtatshme ne nje perpjekje per te zgjeruar Konventen aktuale ne kete territor dhe mundet ne cdo kohe te deklarojne me anen e nje njoftimi me shkrim per Organizaten qe Konventa aktuale do te shtrihet dhe ne kete territor.

b) Konventa aktuale, nga data e marrjes se njoftimit ose nga dite te tjera te tilla sic mund te specifikohet ne njoftim, do te shtrihet ne territorin e emeruar ne njoftim.

2. a) Kombet e Bashkuar ose cdo Qeveri Kontraktuese, e cila "ka bere nje deklarate sipas nenparagrafit (a), te paragrafit (1) te ketij neni, ne cdo kohe pas skadimit te periudhes prej pese vjetesh nga data ne te cilen eshte shtrire mbi cdo territor, mundet me anen e njoftimit me shkrim drejtuar organizates te deklaroje qe Konventa aktuale do te pushoje shtrirjen ne cdo territor te tille te emeruar ne njoftim.

b) Konventa aktuale do te pushoje shtrirjen ne cdo territor te permendur ne njoftime te tilla, nje vit ose per nje periudhe te tille sic mund te specifikohet ne njoftim, pas dates se marrjes se njoftimit nga Organizata.

3. Organizata do te informoje te gjitha Qeverite Kontraktuese per shtrirjen e Konventes aktuale ne cdo territor sipas nenparagrafit (1) te ketij neni dhe per perfundimin e cdo shtrirje te tille sipas parashikimeve te paragrafit (2) duke shpallur ne cdo rast daten, nga e cila Konventa aktuale ka qene ose do te pushoje shtrirjen.

Neni 21 Depozitimi dhe regjistrimi

1. Konventa aktuale do te depozitohet tek Organizata dhe Sekretari i Pergjithshem i Organizates do t'i transmetoje kopjet e verteta te noterizuara tek te gjitha Qeverite firmose dhe tek te gjitha Qeverite, te cilat hyjne ne Konventen aktuale.
2. Menjehere pasi Konventa aktuale hyn ne fuqi, teksti do te transmetohet nga Sekretari i Pergjithshem i Organizates, tek Sekretari i Kombeve te Bashkuara per regjistrim dhe publikim, ne perputhje me nenin 102 te Kartes se Kombeve te Bashkuara.

Neni 22 Gjuhet

Konventa aktuale eshte bere ne nje kopje te vetme ne gjuhet anglisht dhe frengjisht, duke gene te dy tekstet autentike te barabarta. Perktimi zyrtar ne gjuhet ruse dhe spanjolle do te pergatitet dhe depozitohet me firma origjinale.

Si deshmi kudoqofte, nenshkruesit e autorizuar nga qeverite e tyre respektive per kete qellim firmosen Konventen aktuale.

Bere ne Londer ne ditën e njezet e trete te qershorit 1969.

Rregulli 1 Te pergjithshme

ANEKSI I

RREGULLAT PER PERCAKTIMIN E TONAZHEVE BRUTO
DHE NETO TE ANIJEVE

1. Tonazhet e nje anijeje do te perbehen nga tonazhi bruto dhe neto.
2. Tonazhi bruto dhe neto do te percaktohet ne perputhje me parashikimet e ketyre rregullave.
3. Tonazhi bruto dhe neto e nje tipi te ri mjeti, cilesite konstruktive te te cilit jane te tilla sa te bejne zbatimin e parashikimeve te ketyre rregullave te paarsyeshme ose jo praktike, do te percaktohen nga administrata. Kur tonazhi eshte percaktuar ne kete menyre, administrata do t'i komunikojë Organizates detaje te metodes se perdorur per kete qellim, per ta qarkulluar tek Qeverite Kontraktuese per informimin e tyre.

Rregulli 2

Perkufizimi i termave te perdorura ne anekse

1. Kuverta e siperme

Kuverta e siperme, eshte kuverta me e siperme e plote e ekspozuar ndaj detit dhe motit, e cila ka mjetet e perhershme hermetike ndaj ujit ne te gjitha daljet me pjesen e motit dhe poshte te ciles te gjitha hapjet ne dy anet e anijes jane pajisur me mjete te perhershme hermetike ndaj ujit. Ne anijet qe kane nje kuverte te siperme te shkallezuar, vija e poshtme e kuvertes se ekspozuar dhe vazhdimi. i kesaj vije paralel me kuverten e siperme merret si kuverte e siperme.

2. Thellesia maksimale (moulded)

a) Thellesia eshte distanca vertikale e matur nga fundi i kilit deri ne pjesen e poshtme te kuvertes se siperme ne anet. Ne anijet prej druri dhe ato te kompozuara distanca matet nga qoshja e poshtme e brinjës se kilit, ku forma ne pjesen e poshtme te seksionit te mesit te anijes eshte e nje karakteri konkav ose kur jane vendosur mbrojtese

te trasha, distanca matet nga pika ku vija e sheshit te fundit vazhdon ne drejtimin e brendshem te anes se kilit.

b) Ne anijet qe kane forme te rrumbullakte, thellesia maksimale (moulded) do te matet nga pika e nderprerjes se vijes (moulded) te kuvertes dhe lamjeres anesore, vijave qe shtrihen sikur te ishte pjese e rrumbullakte ne forme kendore.

c) Kur kuverta kryesore eshte e shkallezuar dhe pjese e ngritur e kuvertes shtrihet mbi piken ne te cilen thellesia moulded duhet te percaktohet, thellesia moulded do te matet me vijen referuese, qe shtrihet nga pjese me e poshtme e kuvertes gjate vijes paralele, me pjesen me te ngritur.

3. Gjeresia

Gjeresia eshte gjeresia maksimale e anijes, e matur ne mesin e anijes ne vijen moulded te kllapave ne nje anije me bord metalik dhe ne sipërfaqen e jashtme te skafit ne nje anije me bord te cdo materiali tjetër.

4. Hapesirat e mbyllura

Hapesirat e mbyllura Jane ato hapesira te cilat kufizohen nga skafi i anijes, me pjeseza fikse ose te levizshme, ose paratije me kuverten, ose mbulesa pervecse kapak te perhershem ose te Ievizshem. Asnje kllape ne kuverte dhe asnje hapje ne skafin e anijes, ne kuverte ose ne mbulesen e nje hapesire, ose ne seksione, ose paratije te hapesirave dhe as mungesa e seksionit ose paraties, do te pengojë nje hapesire nga perfshirja ne nje hapesire te mbyllur.

5. Hapesirat e perjashtuara

Pa marre parasysh parashikimet e paragrafit (4) te ketyre rregullave, hapesira referuar ne nenparagrafet (a) deri (e) te perfshira ne kete paragraf do te quhen hapesira te perjashtuara dhe nuk do te perfshihen ne volumin e hapesirave te mbyllura, me perjashtim te hapesirave te tilla te cilat plotesojne se paku nje nga tle pikat qe vijojne, do te cilesohen si hapesira te mbyllura:

- hapesira eshte e pajisur me kapak ose mjete te tjera per sigurimin e ngarkeses ose ushqimeve;

- hapjet Jane te pajisura me cdo mjet mbylles;

- konstruksioni parashikon cdo mundesi qe hapje te tilla te mbyllen;

a. i) Nje hapesire brenda nje konstruksioni te kundert dhe fundit te shtrirjes se hapjes nga kuverta ne kuverte me perjashtim te lamjerave perde te nje thellesie qe nuk kalon me shume se 25 milimetra (nje inch) thellesia e traversave bashkuese te kuvertes, hapje te tilla qe kane nje gjeresi te barabarte ose me te madhe se 90 per qind te gjereses se kuvertes ne vijen e hapjes se hapesires. Ky parashikim do te zbatohet ne menyre te tille qe te perjashtojë nga hapesirat e mbyllura vetem hapesirat ndermjet fundit aktual te hapjes dhe nje vije te hequr paralelisht me vijen ose faqen e hapjes ne nje distance nga hapja e barabarte me gjysmen e gjereses se kuvertes ne vijen e hapjes (figura 1 ne apendiksin 1).

(ii) Ne rast se gjeresia e nje hapesire, per arsye te ndonje rregullimi me perjashtim te konvergences se lamjerave te jashtme, behet me pak se 90 per qind te gjereses se kuvertes, vetem hapesira ndermjet vijes se hapjes dhe vijes paralele te hequr nepermjet pikes, ku pjeset kendore te gjereses se anijes behen te barabarta ose me pak se 90 per qind e gjereses se kuvertes do te perjashtohen nga volumi i hapesirave te mbyllura (figurat 2,3 dhe 4 ne apendiksin 1).

(iii) Kur nje interval, i cili eshte komplet i hapur, me perjashtim te paratijeve ose traversave te hapura qe ndajne dy hapesira, perjashtimi i njeres ose te dyjave lejohet sipas nenparagrafeve (a)(i) dhe/ose (a)(ii), perjashtime te tilla nuk do te zbatohen nese ndarja ndermjet dy hapesirave eshte me pak se se paku gjysma e gjeresise se kuvertes ne rrugen e ndarjes (figurat 5 dhe 6 ne apendiksin 1).

b) Nje hapesire ne kuverten e bashit qe mbulon hapjet kundrejt detit dhe motit dhe qe nuk ka lidhje tjeter ne anet e ekspozuara me trupin e anijes vetem me perforcuesit e nevojshem per mbeshtetjen e saj. Ne hapesira te tilla, traversat e hapura ose nje paratie dhe nje lamjere perde mund te pajisen ose mbeshteten te kapura ne bordet e anijes, me kusht qe distanca ndermjet majes se traversave ose paratijes dhe lamjeres perde nuk eshte me e vogel se 0,75 meter (2-5 feet) ose nje e treta e lartesis se hapesires, ciladoqofte me e madhe (figura 7 ne apendiksin 1).

c) Nje hapesire ne konstruksion nga ana ne ane direkt ne rruge te kundert hapjesh me jo me pak ne lartesi 0-75 metra (2-5 feet) ose nje te terten e lartesis se konstruksionit, ciladoqofte me e madhe. Nese hapja ne kete konstruksion te tille parashikohet vetem ne nje aile, hapesira qe duhet te perjashtohet nga volumi i hapesirave te mbyllura do te kufizohet brenda bordit nga hapja, maksimumi sa gjysma e gjeresise se kuvertes ne rrugen e hapjes (figura 8 ne apendiksin 1).

d) Nje hapesire ne nje konstruksion menjehere poshte nje hapjeje te pambuluar ne kuverten e perparshme, me kusht qe nje hapje e tille te jete e ekspozuar ndaj motit dhe hapesira e perjashtuar nga hapesirat e mbyllura kufizohet ne zonen e hapjes (figura 9 ne apendiksin 1).

e) Nje interval ne kufirin e paratijeve te nje konstruksioni i cili eshte i ekspozuar ndaj motit dhe hapjeve, te cilat shtrihen nga kuverta ne kuverte pa mjete mbyllje, me kusht qe kjo gjeresi e brendshme nuk eshte me e madhe se sa gjeresia ne hyrje dhe shtrirja e saj ne konstruksion nuk eshte me e madhe se dy here gjeresine e hyrjes se saj (figura 10 ne apendiksin 1).

6. Udhetar

Nje udhetar eshte cdo person, perve se:

- a) Kapitenit dhe anetareve te ekuipazhit ose personave te tjere te punesuar, ose perfshire me do detyre ne bordin e anijes ne biznesin e kesaj anije;
- b) nje femije me moshe nen nje vje .

7. Hapesirat e ngarkeses

Hapesirat e ngarkeses per t'u perfshire ne llogaritjet e tonazhit neto Jane hapesirat e mbyllura te pershtatshme per transportin e ngarkeses, e cila duhet te shkarkohet nga anija, me kusht qe keto hapesira te tilla Jane perfshire ne llogaritjet e tonazhit bruto. Hapesira te tilla per ngarkese duhet te vertetohen nga shenja te perhershme me germet CC (hapesira ngarkese) te vendosura ne menyre te tille qe te jene te lexueshme dhe te mos jene me pak se 100 milimetra (4 inches) ne lartesi.

8. Hermetizim

Hermetizim nenkupton qe ne do kondite te detit, uji do te penetroje ne anije.

Rregulli 3 Tonazhi bruto

Tonazhi bruto (GT) i nje anijeje do te percaktohet me anen e formules qe vijon:

$$GT = KI V$$

Ku: V=Volumi total i hapesirave te mbyllura te anijes ne meter kub.

$$K1 = 0.02 + 0.02 \log_{10} V \text{ (ose si llogaritet ne apendiksin 2)}$$

Rregulli 4 Tonazhi neto

1. Tonazhi neto (NT) i nje anijeje do te percaktohet nga formula qe vijon:

$$NT = K2 \times Vc (4d/3D)^2 + K3(N1 + N2/10)$$

Ku ne kete formule:

a) Faktori $(4d/3D)^2$ nuk do te merret me i madh se njesia;

b) Temri $K2 \times Vc (4d/3D)^2$ nuk do te merret me pak se 0,25 GT;

c) NT nuk do te merret me pak se 0,30 GT dhe ne te cilen:

Vc = eshte volumi total i hapesirave te ngarkeses ne meter kub

$K2 = 0,2 \pm 0,02 \log_{10} V_0$ (ose sic paraqitet ne tabelen e apendiksit 2)

$$KJ = 1,25 GT + \frac{10000}{10000}$$

D = thellesia moulded ne mes te anijes ne metra sic percaktohet ne rregullat 2 (2).

d = pershkimi moulded ne mes te anijes ne metra sic percaktohet ne paragrafin (2) te ketij rregulli.

$N1$ = numri i udhetareve ne kabina me jo me shume se 8 shtreter.

$N2$ = numri i udhetareve te tjere.

$N1 + N2$ = numri total i udhetareve te anijes se lejuar per transport si9 tregohet ne Certifikaten e udhetareve te anijes. Kur $N1 = N2$ eshte me pak se 13, $N1$ dhe $N2$ duhet te merret zero.

GT = tonazhi bruto i anijes sic percaktohet ne perputhje me parashikimet e rregullave 3.

2. Pershkimi moulded (d) i referuar ne paragrafin (1) te ketyre rregullave do te jete nje nga pershkrimet e meposhtme:

a) per anijet ne te cilat zbatohet Konventa Nderkombetare mbi vijat e ngarkeses ne fuqi, peshkimi qe i korrespondon vijes se ngarkeses verore (pervecse vijes se ngarkeses per dru) te caktuar ne perputhje me kete Konvente;

b) per anije udhetarësh, peshkimi qe i korrespondon vijes se ngarkeses me te madhe te caktuar ne perputhje me Konventen Nderkombetare per Shperthimin e Jetes ne Det ne fuqi dhe marreshjeve te tjera kur jane te zbatueshme;

c) per anijet ne te cilat Konventa Nderkombetare mbi Vijat e Ngarkeses nuk zbatohet, par te cilave u ka qene caktuar nje vije ngarkese ne perputhje me kerkesat kombetare, peshkimi korrespondues per vijen e ngarkeses verore po ashtu i eshte caktuar;

d) per anijet te cilave nuk u eshte caktuar vije ngarkese, por peshkimi i te cilave eshte i kufizuar ne perputhje me kerkesat kombetare, peshkimi maksimal i lejuar;

e) per anijet e tjera, 75 per qind e peshkimit moulded ne mes te anijes sic percaktohet ne rregullat 2(2).

Rregulli 5 Ndryshimi i tonazhit neto

1. Kur karakteristikat e nje anijeje te tilla si V, Vc, d, N1 ose N2, sic percaktohen ne rregullat 3 dhe 4, jane ndryshuar dhe ku nje ndryshim i tille rezulton ne nje rritje ne tonazhin neto te tij, sic percaktohet ne perputhje me parashikimet e rregullit 4, tonazhi neto i anijes qe i korrespondon karakteristikave te reja do te percaktohet dhe do te zbatohet pa asnje vonese.
2. Nje anijeje te ciles vijat e ngarkeses referuar ne nenparagrafet (2)(a) dhe (2)(b) te rregullit 4 i jane caktuar menjehere do t'i jepet vetem nje tonazh neto, sic percaktohet ne perputhje me parashikimet e rregullit 4 dhe ky tonazh do te jete tonazhi i zbatueshem per vijat e ngarkeses respektive per tregti ne te cilen anija eshte e perfshire.
3. Kur karakteristikat e nje anijeje te tilla si V, Vc, d, N1 ose N2, sic percaktohen ne rregullat 3 dhe 4, jane te ndryshuar ose kur vija e ngarkeses respektive e caktuar ne paragrafin (2) ketij rregulli eshte ndryshuar si rezultat i ndryshimit te tregtise ne te cilen anija eshte perfshire dhe ku nje ndryshim i tille rezulton ne nje ulje te tonazhit neto te tij, sic percaktohet ne perputhje me parashikimet e rregullit 4, nuk do te leshohet nje Certificate Nderkombetare Tonazhi (1969) qe permban tonazhin neto te percaktuar deri ne kalimin e dymbedhete muajve nga data ne te cilen Certifikata aktuale ishte leshuar, me kusht qe nje kerkese e tille nuk do te zbatohet:
 - a) nese anija transferohet ne flamurin e nje shteti tjeter;
 - b) nese anija peson ndryshime ose modifikime te cilat konsiderohen nga administrata qe jane te nje karakteri te madh, sic jane heqja e nje superstrukture, te cilat kerkojne nje ndryshim te vijes se caktuar te ngarkeses;
 - c) ne nje anije udhetaresh e cila eshte perfshire ne transportin e nje numri te madh udhetaresh pa shtreter ne tregti speciale, te tille per shembull udhetare turistik.

Rregulli 6 Llogaritja e volumeve

1. Te gjitha volumet e perfshira ne llogaritjen e tonazheve neto dhe bruto do te maten, pavaresisht nga pajisja me jasteqe ajri ose te ngjashme, ne vijen e brendshme te kufirit te skafit ose lamjerave kufizuese te struktureve ne anijet me konstruksion metalik dhe ne pjesen e jashtme te kufirit te siperfaqes per anijet me konstruksion prej materialeve te tjera.
2. Volumet e anekseve do te perfshihen ne volumin total.

Rregulli 7 Dimensionet dhe llogaritja

1. Te gjitha dimensionet e perdorura ne llogaritjet e volumeve do te merren me perafersi te centimetrit ose nje te njezete e nje kembe.
2. Volumet dote llogariten me metoda te pranuar ne pergjithesi per hapesirat e interesuara dhe me saktesi te pranueshme nga administrata.
3. Llogaritja duhet te jete e detajuar ne menyre te kenaqshme per te lejuar kontrollin me lehtesi.

KOEFICIENTET K1 DHE K2 REFERUAR NE RREGULLAT 3 DHE 4(1)

V ose V c = Valumi ne meter kub

V ose Vc	K1 ose K2	V ose Vc	K1 ose K2	V ose Vc	K1 ose K2
10	02200 45000	02931 330000	03104 670000	03165	
20	02260 50000	02940 340000	03106 680000	03166	
30	02295 55000	02948 350000	03109 690000	03168	

40	02320	60000	02956	360000	03111	700000	03169
50	02340	65000	02963	370000'	03114	710000	03170
60	02356	70000	02969	380000	03116	720000	03171
70	02369	75000	02975	390000	03118	730000	03173
80	02381	80000	02981	400000	03120	740000	03174
90	02391	85000	02986	410000	03123	750000	03175
100	02400	90000	02991	420000	03125	760000	03176
200	02460	95000	02996	430000	03127	770000	03177
300	02495	100000	03000	440000	03129	780000	03178
400	02520	110000	03008	450000	03131	790000	03180
500	02540	120000	:03016	460000	03133	800000	03181
600	02556	130000	03023	470000	03134	810000	03182
700	02569	140000	03029	480000	03136	820000	03183
800	02581	150000	03035	490000	03138	830000	03184
900	02591	160000	03041	500000	03140	840000	03185
1000	02600	170000	03046	510000	03142	850000	03186
2000	02660	180000	03051	520000	03143	860000	03187
3000	02695	190000	03056	530000	03145	870000	03188
4000	02720	200000	I03060	540000	03146	880000	03189
5000	02740	210000	03064	550000	03148	890000	03190
6000	02756'	220000	03068	560000	03150	900000	03191
7000	02769	230000	03072	570000	03151	910000	03192
8000	02781	240000	03076	580000	03153	920000	03193
9000	02791	250000	03080	590000	I03154	930000	03194
10000	02800	260000	03083	600000	03156	940000	03195
15000	02835	270000	03086	610000	03157	950000	03196
20000	02860	280000	03089	620000	03158	960000	03196
25000	02880	290000	03092	630000	03160	970000	03197
30000	02895	300000	03095	640000	03161	980000	03198
35000	02909	310000	03098	650000	03163	990000	03199
40000	02920	320000	03101	660000	03164	1000000	03200

Koeficientet K1 ose Kz ne vlerat e ndermjetme te V ose Vc do te fitohen me interpolim linear.

ANEKSI"
CERTIFIKATA NDERKOMBETARE E TONAZHIT (1969)

(Vula Zyrtare)

Leshuar sipas parashikimeve te Konventes Nderkombetare mbi Maijen e T onazhit te anijeve, 1969, nen autoritetin e Qeverise se

.....
.....

(Identifikimi i plate zyrtar i vendit)
per te cilin Konventa ka hyre ne fuqi me

19 nga.....identifikimi i plote zyrtar i personit kompetent ose organizates te njohur sipas parashikimeve

=> Data ne te citen kiti u shtri ne fazen e njeite te kanstruksionit (Neni 2(6)), ase data ne te citen anija pesoi ndryshime ase modifikime ose te karakterit maxhor (Neni 3(2)(b)), perkatesisht. '
te Konventes Nderkombetare mbi Permasat e Tonazhit te Anijeve, 1969)

Emri i Anijes, Numuri Dallues ose Germat, Porti i Regjistrimit, Data

DIMENSIONET KRYESORE

Gjatesia (Neni 2(8)) Gjeresia (Regulli 2(3))
mes te anijes deri ne kuverten e siperme (Regulli 2(2))

Thellesia Moulded ne

TONAZHET E ANIJES JANE:

TONAZHIBRUTO

TONAZHINETO

Kjo eshte per le deshmuar se tonazhet e kesaj anije jane percaktuar ne perputhje me parashikimet e Konventes Nderkombetare mbi Tonazhet e Anijeve, 1969

Leshuar ne

.....

...

(vendi i leshimit te certifikates)

.....

(data e leshimit)

.....

(firma a e zyrtarit qe leshon certifikaten)

dhe/ose

(Vula e autoritetit leshues)

Ne se firmoset duhet shtuar paragrafi qe vijon.

Nenshkruesi deklaron qe eshte autorizuar nga Qeveria ne fjale per leshimin e kesaj certifikate

.....
(Firma)

HAPESIRAT E PERFSHIRA NE TONAZHET

TONAZHI BRUTO

TONAZHI NETO

Emri i Hapsires	Pozicioni	Gjatesia	Emri i Hapsires
Pozicioni	Gjatesia		

Nen kuverte

NUMURI I UDHETARVE

(Regulli 4(1))

Numuri i udhetarve ne kabina

Mejo me shume se 8 shtreter

Numuri i udhetarve te tjere

HAPESIRAT E PERJASHTUARA, (Regulli 2(3)) PESHKIMI MAKSIMAL (MOULDED),(Regulli 4 (2))

Nje yll (*) duhet te shtohet ne ato hapsira te listuara me siper te cilat perfshijne te dyja hapsirat e mbyllura dhe te perjashtuara

Data dhe vendi i matjeve origjinale.....

Data dhe vendi i matjeve te fundit te perpareshmer.....

VEREJTJE

Termat Nderkombetare mbi Marrjen e Tonazhit te anijeve 1969, te tilla si "gjatesi", "gjeresia", "udhetar" dhe "hermatizim", jane te njejta me ato te perdorura ne konventat e tjera ne te cilat Organizata Konsultative Nderqeveritare Detare eshte depozituese, rekomandon qe qeverite kontraktuese duhet te marrin masat per te siguruar qe definicionet identike te termave te perdorura ne konventa te tilla jane interpretuar ne menyre uniforme dhe te qendrueshme.